

Syllabusi i lëndës: Testimi psikologjik në shkollë

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë |
| Titulli i lëndës: | Testimi psikologjik në shkollë |
| Niveli: | Master |
| Statusilëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | III |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 5 |
| Koha / lokacioni: | Për t’u definuar |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Ass. Dr. Aliriza Arënliu |
| Detajet kontaktuese: | Aliriza.arenliu@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | |
| Përshkrimi i lëndës | Kjo lëndë shtjellon teoritë dhe teknikat e administrimit, vlerësimit dhe interpretimit të testeve psikologjike. |
| Qëllimet e lëndës: | |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Lënda është e ndarë në tri sesione.</p> <p>1. Sesioni i parë përfshin elaborimin e principeve bazike të psikometrisë dhe aplikimin e tyre në të gjitha llojet e testeve psikologjike.</p> <p>2. Sesioni i dytë përqendrohet në çështjet e ndërlidhura me administrimin, vlerësimin dhe interpretimin e testeve, të cilat përdoren në bazë të standardeve të vlerësimit.</p> <p>3. Në sesionin e fundit të kësaj lënde, studentët do të përfitojnë njohuri, duke punuar drejtpërdrejtë me testet e standardizuara. Në bazë të situatave të testuara, studentët do të numërojnë rezultatet dhe interpretojnë testet, të cilat ata i kanë administruar tek partnerët e tyre në klasë, në këtë rast do të jenë, duke luajtur rolin e karakterit, që do vlerësohet.</p> |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Të marrin njohuri mbi teoritë dhe llojet e testeve psikologjike.</p> <p>Të marrin njohuri mbi administrimin dhe interpretimin e testeve.</p> <p>Të kenë eksperiencë praktike në procesin administrimit dhe interpretimit të testeve.</p> |

| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
|--|--|------------------|------------------|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 2 | 4 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume,seminare | 4 | 4 | 16 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 10 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 5 | 3 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 1 | 2 | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 3 | | 3 |
| Totali | | | 125 |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Ligjërimi do të jetë interaktiv dhe studentët do të kenë mundësi të eksperimentojnë vetë procesin e administrimit dhe interpretimit të testeve psikologjike. | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 10% Administrimi dhe interpretimi i testeve: 30% Provimi final: 60% | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | Booney, H. (1998). <i>Psychological assessment of children: best practices for school and clinical settings</i> . Wiley, ISBN: 0471193011. | | |
| Literatura shtesë: | Steven, E. Kratochwill. (2000). <i>Behavioral Assessment in Schools, Second Edition: Theory, Research and Clinical Foundations</i> , Guilford Press. | | |

| Plani i detajizuar | |
|--------------------|---|
| Java | Temat |
| Java 1; | Praktikat më të mira të testeve psikologjike tek fëmijët: Trendet dhe Çështjet e ndryshme |
| Java 2; | Vlerësimi joformal |
| Java 3; | Vlerësime neuro-psikologjike |
| Java 4; | Testimi i aftësive sociale dhe marrdhënieve ndërpersonale |
| Java 5; | Testimi i aftësive motorike dhe perceptive |
| Java 6; | Roli i teknologjisë në teste |
| Java 7; | Testimi i Intelegjencës |
| Java 8; | Testimi i sjelljeve adaptive |
| Java 9; | Testimi i fëmijëve të moshave shumë të herëshme |
| Java 10; | Përsërtije |
| Java 11; | Testimime psiko-edukative për fëmijët nga kultura dhe gjuhë tjera |
| Java 12; | Testimi i fëmijëve me ngecje mendore |
| Java 13; | Testimi i fëmijëve me nevoja të veçanta |
| Java 14; | Administrimi dhe interpretimi i testeve (<i>studentët</i>) |
| Java 15; | Administrimi dhe interpretimi i testeve (<i>studentët</i>) |

Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:

- Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm;
- Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore;
- Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;
- Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit;
- Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;